

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEPARTAMENTI PËR KRIME**

**TË RËNDA**, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari Ibrahim Idrizi, kryetar i trupit gjykues, dhe gjyqtarëve profesional Agim Maliqi e Elmaz Zenuni anëtarë të trupit gjykues, me sekretaren juridike Qëndresa Bobi, në çështjen penale kundër të akuzuarve N. M.1 - N. M.2 për shkak të një vepre penale vrasja e rëndë nga neni 147 par. 1 nën par. 5 e 9, të një vepre penale vrasja e rëndë në tentativë nga neni 147 par. 1 nën par. 5 e 9, lidhur me nenin 20, të kryera në bashkëkryerje lidhur me nenin 23 dhe të veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 2 të KPK-së, për të akuzuarin N. M1, të akuzuar sipas aktakuzës së Ish Prokurorisë Publike të Qarkut në Prishtinë PP.nr 741-7/2007 të datës 15.05.2008, pas mbajtjes së shqyrtimeve gjyqësore, orale e publike, më 27 prill 2015, në prani të prokurorit të shtetit Florije Salihu -Shamolli, të akuzuarve N. M.1 e N. M.2 dhe avokatëve mbrojtës Aziz Rexha e Avni Ibrahimimi, shpalli dhe publikisht komunikoi, ndërkaq më 8 qershor 2015 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari:**

**N. M.1**, i biri i S.... dhe nënës Z....., e gjinisë H.... i lindur me datë ....., në fsh....., Shtime, tani me banim në rrugën “.....” në Shtime, shqiptar, shtetas i Republikës Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, prind i 4 fëmijëve, me gjendje të mesme ekonomike, në paraburgim prej 07.11.2007.

## I.

### Është fajtor

1. Se më date 07.11.2007, rreth orës 15:30 min, në fshatin Belincë, K. Shtime, në platon e pompës së benzinës “.....”, me dashje dhe motive të hakmarrjes e ka privuar nga jeta tani të ndjerin B. B, në atë mënyrë që nga vetura e tipit Passat me targa ....., posa ka vërejtur të parkuar veturën e tipit Peugeot me ngjyre të bardhë e cila ishte e parkuar në oborrin e pompës së benzinës, e që në ulësen e vozitësit të kësaj veture ishte i ulur tani i ndjeri B. B, i akuzuari N. M.1 nga vetura e tij që ishte ndalur paralel me veturën e tani të ndjerit, ne një distancë prej rreth 2-3 metra, e hap derën e pasme të djathtë të veturës, nga ulësja e pasme e merr pushkën automatike AK-47 , cal 7.62 mm, dhe nga kjo afërsi hap zjarr me rafal në drejtim të veturës Peugeot, e që predhat fillimisht qëllojnë derën e parë të majtë të kësaj veture, depërtojnë në brendësi të veturës dhe 17 plumba e qëllojnë tani të ndjerin B. në pjesë të ndryshme të trupit duke shkaktuar plagë në anën e pasme dhe të përparme të trupit, dhe që nga plagët e marra tani i ndjeri ndërron jetë.

- **me këtë kreu veprën penale vrasja e rëndë nga neni 147 par. 1 nën par. 9 të KPK-së.**

2. në kohë, vend dhe mënyrën e përshkruar si në piken 1 të dispozitivit të aktgjykimit, nga pakujdesia, ka shkaktuar rrezik të madh për jetën e njerëzve apo për pasurinë në atë mënyrë që nga ulësja e djathtë e pasme e veturës të markës Passat, ka hapur zjarr nga arma – pushka automatike AK-47 në drejtim të veturës Peugeot të të ndjerit B. B e që predhat e kanë qëlluar edhe veturën Wolsfagen me targa ..... që ishte e parkuar afër veturës së tani të ndjerit, dhe duke mos e ditur se brenda në veturën Wolsfagen ishte duke fjetur tani i dëmtuari R. M, e që veturën e kishte parkuar në oborrin e pompës së benzinës “ .....” për të pushuar dhe që ishte duke fjetur në ulësen e shtrirë të vozitësit dhe nga të shtënat është zgjuar dhe vëren se disa predha kishin qëlluar edhe trupin e tij dhe atë në pjesë të ndryshme të trupit e që nga këto plagët ka marr lëndime të rënda trupore në formë të një plage shkuese në zonën e shuplakës së djathtë të dorës e shoqëruar me thyerjen në zonën e nyjzimit (artikulare) të

ashtit të parë metacarpal të gishtit të madh të dorës së djathtë, kufi të faqes së pasme dhe asaj anësore të bërrylit të majtë, në murin e përparme të barkut në zonën e nën këthizës si plagë tejshkuese – tangjentiale , me vrimën hyrëse në anën e djathtë të barkut ndërkaq vrima dalëse nuk është përshkruar e që me besueshmëri është pjerrët e vendosur dhe është në thellësi të indeve deri në 3 cm, duke shkaktuar kështu lëndime të rënda trupore me dëmtim të përkohshëm në shëndetin e të dëmtuarit,

**-me këtë kreu veprën penale shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291 par. 6 lidhur me par. 1 të KPK-së.**

3. se nga data e pa përcaktuar deri më 07.11.2007, ka mbajtur në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar – pa leje valide pushkën automatike AK -47 kal 7.62mm, me numër serik ..... të cilën e ka përdorur në mënyrën e përshkruar si në piken 1 dhe 2 të dispozitivit, dhe e cila armë sekuestrohet nga policia,

**-me këtë kreu veprën penale mbajtja në pronësi, në kontroll, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 2 të KPK-së.**

Andaj gjykata në bazë të dispozitave të neneve 3, 6, 11, 15, 16, 34, 38, 39, 64, 71, neni 147 par 1 nen par 9, të nenit 291 par. 6 lidhur me par. 1, të nenit 328 par. 2 të KPK-së, si dhe të nenit 365 të KPPK-se, konstaton dhe atë:

1. Për veprën penale vrasja e rëndë nga neni 147 par. 1 nen par. 9 të KPK-së, të përshkruar si në piken I/1 të dispozitivit, dënim burgimi në kohëzgjatje prej 17 vite.

2. Për veprën penale shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291 par. 6 lidhur me par. 1 të KPK-së, të përshkruar si në piken I/2 të dispozitivit, dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 vit e 6 muaj.

Dhe gjykata bazuar në nenin 71 të KPK-së, si dhe të dispozitave të cekura ligjore,

## **E g j y k o n**

Me dënim unik burgimi ne kohëzgjatje prej 18 (tetëmbëdhjetë) vite.

Për veprën penale mbajtja në pronësi, në kontroll, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 2 të KPK-së, të përshkruar si në piken 3 të dispozitivit, dënim gjobe në shumë prej 600 euro.

Në dënimin e shqiptuar me burgim do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim dhe atë prej datës 07.11.2007, deri sa aktgjykimi të merr formën e prerë por jo më shumë se koha e dënimit të caktuar me aktgjykim PKR 234/2013 të datës 27 prill 2015.

Ndërkaq dënimin e shqiptuar me gjobë do ta paguaj në afat prej 30 ditësh pasi aktgjykimi të merr formën e prerë, në rast se dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në asnjërën nga format e parapara në nenin 39 të KPK-së, dënimi me gjobë do ti zëvendësohet me dënim burgimi ashtu që për çdo 15 euro do ti llogaritet një ditë burgimi.

Konfiskohet në mënyrë të përhershme pushka automatike AK-47 e kal 7.62mm, me numër serik ..... dhe një karikator për këtë pushkë automatike.

Obligohet i akuzuari që ti paguaj gjykatës shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 122.62 euro, si dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumë prej nga 400 euro , dhe atë në afat prej 30 ditësh pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

## II.

**I akuzuari N. M.2**, i biri i S..... dhe nënës Z....., e gjinisë H....., i lindur me datë....., në fshatin ....., Shtime, tani me banim në rrugën “ .....”, Shtime, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, ka të kryer shkollën fillore, i martuar, prind i dy fëmijëve, i pa punësuar, me gjendje të mesme ekonomike, ka qëndruar në paraburgim prej datës **21.11.2007 deri më 16.03.2012**.

Në bazë të nenit 390 par. 1 nën par 3 të KPPK-së,

### LIROHET NGA AKUZA

1. Se më datë 07.11.2007, rreth orës 15:30 min, në pompën e benzinës “ .....” në fshatin ..... Shtime, me dashje direkte me motive të hakmarrjes bashkë me të akuzuarin N. M.1, e kanë privuar nga jeta tani të ndjerin B. B, ashtu që të dy të akuzuarit me marrëveshje paraprake kanë marrë armën AK -47 dhe me veturën e tyre të tipit Passat me targa ..... kanë shkuar në të njëjtin vend në pompën e benzinës për të marrë hak pasi që 2 vite më parë në të njëjtin vend ishte vrarë vëllai i tyre F.... nga A. B, të cilën veturë e ka drejtuar i akuzuari N. M.2, dhe me të arritur në pompën e benzinës “ ....” e ndal veturën në parking dhe vënë veturën e të ndjerit “ Peugeot” ngjyre e bardhë, në të cilën ishte duke qëndruar i ndjeri B. B, ku me veturën e tyre të akuzuarit janë afruar paralel në një afërsi 2-3 metra dhe në atë moment i akuzuari i parë hap derën e pasme të djathtë dhe nga ulësja e prapme e veturës ka marrë pushkën automatike AK-47 cal 7.62 mm dhe nga afërsia ka shtënë me rafal në derën e parë të veturës Peugeot në ulësen e vozitësit ku ishte ulur viktimi dhe ka goditur me 17 plumba në pjesë të ndryshme të trupit dhe nga eksperti mjeko ligjor dr. T.G janë konstatuar dy lloje plagësh, plagë e anës së pasme të trupit në anën e majtë me nr.1,2,6,7,8,9 dhe 11, dhe plagët e anës së djathtë të pasme të trupit dhe atë nr.3,4,10,12,13 dhe 14, pastaj janë gjetur edhe plagët në pjesën e pasme të trupit e që janë dy plagë tejshkuese me numër 15 e 17 si dhe një plagë tangjenciale dhe plaga me numër 10 është konstatuar se është plagë shkuese e cila ka dëmtuar veshkën e djathtë ku është gjetur predha ndërsa shkaktari i vdekjes është konstatuar se janë

plagët e shumëfishta nga ana e armës së zjarrit në trupin e të ndjerit ku nga këto plagë i ndjeri vdes pastaj të akuzuarit ikin në drejtim të Shtimes.

**-meqë nuk është provuar se në bashkëkryerje me të akuzuarin N.M.2 ka kryer veprën penale vrasja e rëndë nga neni 147 par. nën par. 9 të KPK-së.**

2.Në kohë, vend dhe mënyrën e përshkruar si në pikën 1 të dispozitivit të aktakuzës , të pandehurit , nga pakujdesia , kanë shkaktuar rrezik të madh për jetën e njerëzve apo për pasurinë ashtu që i akuzuari N nga ulësja e prapme e veturës ka hap derën e prapme të anës së djathtë dhe me armën e tipit AK-47 ka shtënë në veturën e të ndjerit B. B ne derën e parë të anës së majtë dhe pastaj ka shtënë edhe ne drejtim të veturës Wosfagen me targa ..... e cila ishte parkuar, duke mos e ditur se është duke fjetur i dëmtuari R. M i cili ishte ndalur për të pushuar në pompën e benzinës “ .....” dhe atë në karrigen e vozitësit e që nga këto të shtëna është zgjuar, sheh se në veturën e tij është shtënë disa herë dhe në trupin e tij është shtënë ku kishte marr plagë në pjesë të ndryshme të trupit ku nga këto plagë merr lëndime të rënda trupore dhe atë një plagë shkuese në zonën e shuplakës së djathtë e shoqëruar me thyerjen në zonën e nyjzimit ( artikulare) të ashtit të parë metacarpal të gishtit të madh të dorës së djathtë, kufi të faqes së pasme dhe asaj anësore të bërrylit të majtë, në murin e përparme të barkut në zonën e nën kërthizës është plagë tej shkuese apo tangjente , me vrimën hyrëse në anën e djathtë të barkut kurse vrimë dalëse nuk është përshkruar dhe e njëjta me besueshmëri është pjerrët e vendosur dhe është në thellësi të indeve deri në 3 cm, që nëse viktima është i dhjamosur trash e përfshinë vetëm lëkurën dhe indet nën lëkurore dhjamore e të cilat dëmtime me besueshmëri vetëm përkohësisht e kanë dëmtuar shëndetin e të dëmtuarit.

**-meqë nuk është provuar se në bashkëkryerje me të akuzuarin N. M.1 kanë kryer veprën penale shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291 par. 6 lidhur me par. 1 të KPK-së.**

Shpenzimet e procedurës penale për këtë të akuzuar bien në barrë të mjeteve buxhetore të Gjykatës

## **A r s y e t i m i**

### **1. Historiku i procedurës dhe aktakuza**

Prokuroria e Qarkut në Prishtinë, me 15.05.2008 ka ngritur aktakuzën PP.nr 741-7/2007, ndaj të akuzuarve N.M.1 e N.M.2 për shkak të veprave penale vrasja e rëndë nga neni 147 par. 1 nën par. 5 e 9, të një vepre penale vrasja e rëndë në tentativë nga neni 147 par. 1 nën par. 5 e 9, lidhur me nenin 20, të kryera në bashkëkryerje lidhur me nenin 23 dhe të veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 2 të KPK-së, për të akuzuarin N. M.1.

Aktakuza e PPQ në Prishtinë është konfirmuar me aktvendimin KA 124/2010 të datës 02.11.2010.

Gjykata e Qarkut në Prishtinë me aktgjykimin P.nr 333/2008 të datës 16.03.2012, të akuzuarit N.M.1 e N.M.2 janë shpallur fajtor për veprën penale vrasja e rëndë nga neni 147 par. 1 pika 5 dhe 9 në bashkëkryerje lidhur me nenin 23 të KPK-së, kurse N.M.1 edhe për një vepër penale të vrasjes në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 dhe të një vepre penale nga neni 328 par. 2 te KPK-së.

Gjykata e Apelit e Kosovës – Departamenti për Krime të Rënda, duke vendosur në procedurë të ankesës, me aktvendimin PAKR.nr 1256/2012 të datës 29.04.2013, e ka anuluar aktgjykimin e shkallës së parë dhe çështjen e ka kthyer në rigjykim.

Duke vepruar sipas kësaj aktakuze, trupi gjykues i Gjykatës Themelore në Ferizaj – Departamenti për Krime të Rënda ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimet gjyqësore me datë

16,17.10.2014, më 25 e 26.11.2014 , 18.02.2015, 02, 03, 08, 10, 20, 24 .04.2015, dhe me 27.04.2015 shpalli aktgjykimin në këtë çështje penale.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor, pas leximit të aktakuzës të akuzuarit N.M.1 e N.M.2 janë deklaruar të pafajshëm për veprat penale të cilat u vihen në barrë me akuzën PP.nr 741-7/2007 të datës 15.05.2008, ndërkaq i akuzuari N.M.1 u deklarua fajtor për veprën penale mbajtja në pronësi, në kontroll, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 2 të KPK-së.

Meqë të akuzuarit nuk e kanë pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës Gjykata duke u bazuar në nenin 359 par. 4 të KPPK-së, shqyrtimin gjyqësor e ka vazhduar me procedurën e provave dhe paraqitjen e mbrojtjes nga të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre.

Pas përfundimit të procedurës provuese, prokurori i shtetit i Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti për Krime të Rënda Florije Salihu – Shamolli e ka ndryshuar aktakuzën fillestare në atë mënyrë që të akuzuarit N.M.1 e N.M.2 i ka akuzuar për kryerjen e një vepre penale dhe atë vrasja e rende nga neni 147 par 1 nen par 9 , të një vepre penale shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291 par 6 lidhur me par 1 te kryer në bashkëkryerje lidhur me nenin 23 KPK-se, ndërkaq të akuzuarin N.M.1. edhe për veprën penale mbajtja ne pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve nga neni 328 par. 2 te KPK-së.

Në fjalët përfundimtare të palëve i ka propozuar Gjykatës që ti shpall fajtor të akuzuarit për veprat penale të cilat u vihen në barrë me akuzën e ndryshuar dhe t'i gjykoj me dënime të parapara me ligj.

Me tutje prokurori ka deklaruar se janë vërtetuar të gjitha faktet e çështjes penale, të vrasjes së tani të ndjerit B. B nga i akuzuari N.M.1. në bashkëkryerje me të akuzuarin N.M.2, në atë mënyrë që ditën kritike me veturën e tipit Passat që e drejtonte N.M.2, kanë shkuar në pompën e benzinës “ .....”, në fshatin .....Shtime, i akuzuari N.2 e ka ndal veturën afër veturës të markës Peugeot, ku në ulësen e parë ishte i ulur tani i ndjeri B., dhe i akuzuari N.1.



nga një distancë e afërt ka shtënë me rafal nga pushka automatike AK- 47 në drejtim të veturës Peugeot dhe duke e qëlluar kështu tani të ndjerin Blerim me 17 plumba, e që i akuzuari N.1. i ka shkrep edhe në drejtim të veturës Wolsfagen e cila ishte e parkuar paralel me veturën Peugeot, ku në ulësen e parë të vozitësit ishte duke fjetur tani i dëmtuari R.M e që të akuzuarit duke mos ditur se në këtë veturë është duke fjetur tani i dëmtuari, me ç ‘rast plumbat e qëllonjë në qafë, në dorë e bark duke i shkaktuar kështu lëndime të rënda trupore.

Të akuzuarit veprën penale të vrasjes së rëndë e kanë kryer nga hakmarrja ngase në të njëjtin vend – në pompën e benzinës “ ..... ”, dy vite më parë një anëtar i familjes së tani të ndjerit B. B, e kishte privuar nga jeta vëllain e të akuzuarve tani të ndjerin F. M. Prokurori më tutje ka shtuar se gjendja e tillë faktike është vërtetuar me të gjitha provat materiale, dëshmitë e dëshmitarëve R.M, Q e S.B si dhe ekspertizat balisitike dhe mjeko ligjore të kryera në këtë çështje penale.

Përfaqësuesi i autorizuar i palëve të dëmtuara av. B.T i ka propozuar trupit gjykues që ti shpall fajtor të akuzuarit për veprat penale për të cilat akuzohen, nuk ka parashtruar kërkesë pasurore juridike - është tërhequr nga realizimi i kërkesës për kompensim të dëmit.

Edhe i dëmtuari R. M, nuk i është bashkangjitur ndjekjes penale ndaj të akuzuarve dhe nuk ka parashtruar kërkesë për kompensimin e dëmit.

## **2.Mbrojtja e të akuzuarve N.M.1. e N.M.2. Mujota**

I akuzuari N.M.1., në mbrojtjen e tij të dhenë në të gjitha fazat e procedurës si dhe në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se me datë 07.11.2007, me veturën e markës Passat me targa ....., në orët e paradites ka shkuar në qytetin Suharekë për të blerë pjesë të traktorit dhe kur është kthyer për në Shtime rreth orës 15:30 min, në parkingun e pompës se benzinës “ .....”, në fshatin ..... Shtime që gjendet afër rrugës magjitrare Suharekë – Shtime, e ka vërejtur të parkuar veturën e markës Peugeot, dhe se në veturë ishte një anëtar i familjes B..- djali i F. B por që emrin nuk ia ka ditur, ka deklaruar se me të vërejtur veturën dhe personin është humbur krejtësisht, e ka ndal veturën paralel me këtë veturë, ka kaluar në ulësen e

pasme, e ka marr pushkën automatike AK -47 që ishte në ulësen e pasme, e ka hapur derën e djathtë të pasme të veturës dhe ka shkrepur një rafal në drejtim të kësaj veture, në derën e vozitësit nga një distancë prej rreth 3-4 metra, në atë moment koha ka qenë e vranët me reshje shiu dhe bore.

Më tutje ka deklaruar se pasi ka fillu të shkrep rafal të automatikut në veturën Peugeot, ka vërejtur që personi i cili ishte i ulur në ulësen e vozitësit, ka tentuar të nxjerr diçka nga brezi, por nuk ka mundur, e që i akuzuari duke hyrë në veturën e tij ka shkrepur në ajër edhe disa plumba nga pushka automatike dhe duke u larguar nga vendi i ngjarjes me veturën e tij, aty afër e ka vërejtur edhe një veturë me ngjyrë të zezë që ishte e parkuar, por nuk ka vërejtur ndonjë person brenda apo jashtë kësaj veture. Me veturën e tij është larguar nga aty në drejtim të Shtimes, dhe në hyrje të qytetit ka dredhuar rrugën në të djathtë në drejtim të fshatit Petrovë, veturën e ka parkuar në oborrin e D.H, e ka marr armen automatike dhe në këmbë ka shkuar në fshatin .....Shtime, në shtëpinë e agjes së tij Sh.M, ka hyrë në “ oden e burrave”, dhe i ka treguar agjes së tij se ka gjuajtur në drejtim të një anëtari të familjes B., ndërkaq mixha i tij Sh. e ka njoftuar policinë të cilët kanë ardhur aty dhe e kanë arrestuar.

Pushkën automatike, ka deklaruar se e ka mbajtur ne kepekun e veturës ndërkaq kur është kthyer prej Suharekës, gjatë rrugës e ka vendosur në ulësen e pasme të veturës dhe këtë nga frika se duke kaluar për skaj të pompës së benzinës “ .....” mund të takohet me anëtarët e familjes B. e ata mund ta vrisnin, nga shkakun se me familjen B kishin konflikt, njeri prej anëtareve të kësaj familje dy vite më parë ia kishin vranë vëllain e tij tani të ndjerin F.M pikërisht në pompën e benzinës “ .....”, që sipas traditave familja M u kishin dhënë “ besë”, familjes B.... për të dal të lirë por jo edhe në pompën e benzinës “ .....” pra në vendin ku i ishte vranë vëllai i tij tani i ndjeri F.... Ditën kritike ka qenë vetëm në veturë, vrasjen e ka kryer vetë.

Sa i përket vëllait të tij N.M.2, ka deklaruar se jetojnë në të njëjtën bashkësi familjare, ndërkaq N.2 ditën kritike ka shkuar në Ferizaj për të rregulluar dokumentet për një vizë, kurse dy vëllezërit e tjerë me të cilët po ashtu jetojnë në bashkësi të njëjtë familjare E.. dhe Fatmiri në atë kohë kanë qenë në Zvicër ku kanë punuar me dokumente të rregullta.

I akuzuari N.M.2 e ka mohuar në tërësi kryerjen e veprave penale për të cilat është akuzuar me akuzën e prokurorit të shtetit. Në mbrojtjen e tij të dhënë në të gjitha fazat e procedurës penale dhe në shqyrtimin gjyqësor, ka deklaruar se nuk ka qenë pjesëmarrës i ngjarjes së ndodhur ditën kritike, me datë 07.11.2007, rreth orës 09:00 të mëngjesit ka dalë prej shtëpisë ku jeton në Shtime dhe ka shkuar në Ferizaj, udhëtimin e ka bërë me kombi bus – taksi, ka shkuar në marketin ..... në Ferizaj, rreth orës 13:00, dhe fillimisht është takuar me një punëtor të marketit të quajtur N.N, me të njëjtin është përshëndetur dhe ka qëndruar shumë shkurt e pastaj është ulur në restorantin e Ben- Afit dhe aty rreth orës 14:30 ka ardhur një person i quajtur B.T prej qytetit Shkup të R. Maqedonisë, kanë qëndruar së bashku rreth 30 minuta e takimi me këtë person ishte përgatitur më herët përmes agjes së tij H., e që biseda është zhvilluar për rregullimin e një vize për shtetin e Greqisë, që i akuzuari N.2. këtij personi ia ka dorëzuar dokumentet me pasaportën dhe paratë e nevojshme për rregullimin e vizës.

Më tutje i akuzuari ka deklaruar në mbrojtjen e tij se është ndarë me këtë person, ka shkuar në stacionin e autobusëve në Ferizaj, ka hipur në autobusin Ferizaj – Shtime , dhe me të arritur në fshatin ....., përmes telefonit mobil e ka ftuar agja i tij H.... dhe e ka njoftuar që të ketë kujdes, sepse vëllai i tij N.1. ka bërë një problem me familjen B..... Ka shtuar me tutje se për t'iu shmangur ndonjë problemi tjetër ka zbritur prej autobusi dhe ka vazhduar rrugën në këmbë për në fshatin .....e gjatë rrugës ka hipur në një veturë vozitësin e se cilës nuk e ka njohur ( por më pastaj ka kuptuar se kush është ky person i cili e ka marrë në veturën e tij), në atë mënyrë që prej fshatit ....., ka vazhduar këmbë në fshatin ..... në shtëpinë e agjes së tij Sh.M dhe kur ka hyrë “ në odë”, aty e ka parë vëllain e tij N....., agjen Sh.. dhe disa persona të tjerë si dhe pjesëtarët e policisë që kryenin kontrollin e shtëpisë, vëllai Na.1. e ka njoftuar se ka gjuajtur me armë në veturën e familjes B..., për çka i akuzuari N.2.....e ka qortuar, e pasi që policet kanë kryer kontrollin e kanë marrë N.1., por nuk kanë kërkuar ndonjë person tjetër e as tani të akuzuarin N.2.. Ka deklaruar se me datë 21.11.2007 e kanë marrë policia për të dhënë deklaratë dhe e kanë arrestuar.

### **3. Qëndrimet e mbrojtësve të të akuzuarve**

Mbrojtësi i të akuzuarit N.M.1., av. A. R, e ka konsideruar si jo kontestuese faktin se i akuzuari N.M.1. e ka privuar nga jeta tani të ndjerin B. B dhe i ka shkaktuar lëndime të rënda trupore të dëmtuarit R. M por sipas qëndrimit të mbrojtësit, i akuzuari N.M.1. vrasjen e të ndjerit Blerim nuk e ka kryer për qëllime të hakmarrjes dhe me këtë nuk e ka pranuar kualifikimin juridik të veprës penale duke deklaruar se i akuzuari nuk ka pas dashje dhe motiv të shkaktimit të lëndimeve trupore ndaj të dëmtuarit R. M.

Sipas qëndrimeve të mbrojtësit, i akuzuari N.M.1. me date 07.11.2007, rreth orës 15:30, deri sa ishte duke vozitur veturën e markës Passat, në drejtimin Suharekë – Shtime , parkingun e pompës së benzinës “ .....,” e ka ndalur veturën pas veturës të markës Peugeot e cila ishte e parkuar aty, ka kaluar prej ulëses së vozitësit në ulësen e pasme të veturës e ka marr pushkën automatike e ka hapur derën e pasme të djathtë të veturës dhe ka shtënë në drejtim të veturës Peugeot, pastaj duke ecur në këmbë ka vazhduar të gjuaj në drejtim të veturës ku ndodhej tani i ndjeri B. B e pastaj është larguar nga vendi i ngjarjes me veturën e tij.

Këto veprime sipas qëndrimeve të mbrojtësit i akuzuari N.M.1. i ka ndërmarr duke qenë i stresuar kur ka vërejtur të parkuar në parkingun e pompës së benzinës veturën e familjes B....., e ka humbur kontrollin, nuk ka mund t’i kontrolloj veprimet e veta, ngase në ato momente ishte në gjendje të tronditjes se fortë dhe në gjendje të aftësisë të zvogëluar mendore, pra, aftësia për t’i kontrolluar veprimet e tij ishte dukshëm e zvogëluar, për faktin se në të njëjtin vend dy vite më parë, nga një anëtar i familjes B... i ishte vrare vëllai i tij tani i ndjeri F. M.

Ne raport me të dëmtuarin R. M, i akuzuari N.M.1. nuk ka pas njohuri se i njëjti ishte duke fjetur në veturën e tij e që ishte e parkuar paralel me veturën e tani të ndjerit Blerim dhe në atë gjendje, nga pakujdesia kur ka shtënë në drejtim të veturës së tani të ndjerit B..... predhat e hedhura nga pushka automatiken e kanë qëlluar edhe të dëmtuarin R. M.

Konsideron se në veprimet e të akuzuarit N.M.1. në raport me vrasjen e tani të ndjerit B.... qëndrojnë elementet e veprës penale vrasje në gjendje të afektit mendor – vrasje e çastit nga neni 148 i KPK-së, ndërkaq në raportin me të dëmtuarin R. M ekzistojnë elementet e veprës penale lëndim i rëndë trupor nga neni 154 par. 6 lidhur me par. 1 te KPK-së, dhe i ka propozuar Gjykatës që gjatë matjes së dënimit të akuzuarit N.M.1. të ia merr për bazë si rrethana lehtësuese pranimin e fajit për vrasjen e tani të ndjerit B....., se më parë nuk ka kryer veprë penale si dhe faktin e normalizimit të raporteve me familjen e të dëmtuarit.

Mbrojtësi i të akuzuarit N.M.2., av. A. I, ka deklaruar se nga të gjitha provat e administruara është vërtetuar që i akuzuari N.M.2. nuk ka qenë i përfshirë në ngjarjen e ditës kritike, atë ditë i akuzuari N.M.2. ishte në Ferizaj, në restorantin e marketit ....., e ky fakt është vërtetuar nga i akuzuari N.M.1., nga dëshmitarët B.T e dhënë para prokurorit i cili ka përshkruar se me datë 07.11.2007 rreth orës 14:30 me të akuzuarin N.M.2. kanë qëndruar në restorantin ..... rreth 30 minuta që kanë biseduar për rregullimin e dokumenteve lidhur me një vizë për të akuzuarin N.M.2.. Këtë fakt e ka vërtetuar edhe dëshmitari N.N, përndryshe punëtor në marketin ..... që ka përshkruar se atë ditë është takuar me të akuzuarin N.M.2. në ambientet e marketit ..... në Ferizaj.

Mbrojtësi, ka shtuar se deklaratat e të dëmtuarve S e Q.B, se ditën kritike rreth orës 15:30 të udhëkryqi në hyrje të Shtimes e kanë vërejtur veturën e markës Passat duke ardhur nga drejtimi i Prizrenit dhe në veturë ishin N.M.1. e N.M.2. Mujota, nuk janë deklarata bindëse dhe të sakta, nuk bazohen në perceptime vetanake por i referohen vrojtimeve të personave të tjerë që bazuar në konfiguracionin e rrugës – kthesë, veturës në lëvizje distancën prej ku e kanë vërejtur veturën e të akuzuarve – 78 metra, kohës që në ato momente ishte vranët dhe me reshje shiu, rezulton se në këto kushte është e pamundur të dallohen – identifikohen personat apo personi brenda në veturë , e kur këtyre u shtohen edhe deklaratat dubioze të këtyre dëshmitarëve të dhëna neper fazat e procedurës penale si dhe deklaratës së dëshmitarit R. M se në vendin e ngjarjes e ka parë personin me armë në dorë duke e përshkruar pamjen e tij, por personin tjetër të ulur në ulësin e vozitësit në veturën Passat nuk

ka mundur ta identifikoj, atëherë me të drejtë konkludohet se i akuzuari N.M.2. nuk ka qenë pjesëmarrës i kësaj ngjarje, edhe provat materiale si ekspertizat balistike kanë konfirmuar se është shtënë vetëm nga një armë e vetme dhe atë nga dera e pasme e djathë e veturës Passat duke ndërruar edhe pozicioni i qitësit e vërtetojnë pafajësinë e të akuzuarit N.M.2. dhe nga këto arsye ka propozuar që i njëjti të lirohet nga akuza.

#### **4.Provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor**

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor ka paraqitur dhe ka vlerësuar dëshmitë e dëshmitarëve dhe atë: Q.B, S.B, R.M.1., R.M., Sh. M, Z.M, H.M, I,I, A.M, N.N e B.T si dhe këto prova materiale:

- Autopsia MA07-289 e datës 20.02.2008 e kryer nga zyra persona të zhdukur dhe mjekësi ligjore,
- Transkriptet e hyrje – daljeve nga PTT- Vala 900 nga numri i telefonit .....
- Vërtetimi për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i datës 07.11.2007,
- Procesverbali për përkufizimin e veturës te datës 09.11.2007,
- Raporti i këqyrjes në vendin e ngjarjes nga krim teknika VN # 74-07-R i datës 07.11.2007,
- Skica e pompës së benzinës “ .....” në fsh ....., Shtime,
- Shënimi zyrtar i policeve hetues të datës 08.11.2007 dhe raporti fillestar,
- Raporti mjekësor PP.741-7/07 i datës 20.05.2008, për R.M,
- Raporti plotësues i policisë te datës 14.12.2007 për CD-të, të sekuestruar në QT ...,
- Deklaratë e dëshmitarit – policit A.M e dhënë në shqyrtimin gjyqësor më 07.09.2011,
- Ekspertiza e përbashkët e ekspertit mjeko – ligjor dhe atij të balistikës, PP.nr 741-7/07 të datës 13.07.2009,
- Raporti mjekësor për të akuzuarin N.M.1. nr.332/10 të datës 08.03.2010, nga Kabineti për Elektro miografi, si dhe mendimi i ekspertit mjeko ligjor të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës 02.02.2011,

- Raporti i rikonstruksionit të vendit të ngjarjes i datës 11.10.2011, bashkë me procesverbalin P.nr 333/08 të datës 11.10.2011,
- Mendimi i ekspertit të balistikës të dhënë në shqyrtimin gjyqësor me 17.03.2011,
- Mendimi i ekspertit mjeko ligjor dhe atij të balistikës i dhënë në shqyrtimin gjyqësor me date 07.01.2012,
- Raporti i përbashkët i ekspertëve në rikonstruksionin e vendit të ngjarjes i datës 11.10.2011,
- Dëshmia e dëshmitarit B.T e dhënë në ish PPQ në Prishtinë më datë 31.01.2008,
- Mendimi i ekspertit nga lëmia e kamerave i dhënë në shqyrtim gjyqësor me datë 02.04.2015,

### **5.Përmbledhje e dëshmime të dëshmitarëve**

**Dëshmitarët Q. B** në shqyrtimin gjyqësor kanë deklaruar se më datë 07.11.2007, rreth orës 15:00 ishin ndalur me veturën e tyre në udhëkryqin për në fshatin ....., Shtime, për shkak të defektit në veturë, dhe deri sa ishin jashtë veture kanë vërejtur veturën e markës Passat të familjes M.... që vinte nga drejtimi Suharekë – Shtime dhe ka dredhuar në të djathtë në drejtim të fshatit Petrovë, vetura ka lëvizur me një shpejtësi mjaft të madhe dhe nisur nga fakti se dëshmitarët me familjen M ishin në konflikt, prania e veturës Passat ua ka tërhequr vëmendjen, distanca prej vendit ku kanë qenë deri te vendi ku vetura ka dredhuar në të djathtë ishte rreth 20-30 metra kurse koha në ato momente ka qenë e vranët dhe kohë pas kohe me riga shiu, por sipas dëshmitarëve pamja ka qenë e mjaftueshme në atë distancë dhe dëshmitarët në veturën Passat i kanë parë tani të akuzuarit N.M.2. dhe N.M.1. kurse dëshmitari Q.B ka deklaruar se në veturën Passat e ka parë dhe e ka njohur të akuzuarin N.M.2. i cili ishte duke e vozitur këtë veturë, ndërkaq personin tjetër që ishte i ulur në ulësen e parë të veturës nuk e ka njohur.

Përndryshe që të dy dëshmitarët, kanë deklaruar se të akuzuarin N.M.2. e kanë njohur edhe përpara ngjarjes, dëshmitari Q.B ka deklaruar se të akuzuarin N.M.1. nuk e ka njohur

para se të ndodh ky rast , ndërkaq dëshmitari S..... e ka njohur edhe N.M.1. para se të ndodh rasti dhe ka deklaruar se është i bindur që i akuzuari N.M.2. ditën kritike e ka vrarë vëllain e tij tani të ndjerin B. B, e këtë bindje e ka mbështetur në faktin se N.M.2.u ka kundërshtuar dhënien e besës për familjen B..... nga familja M..... para ndodhjes së këtij rasti, e këtë e ka mbështetur edhe në thënien tjetër se një ditë para rastit N.M.2.un e ka parë afër shkollës “ E.D”, dhe të njëjtin e ka përcjellë meqë një anëtar i familjes B... dy vite më parë kishte vrarë vëllain e të akuzuarit N.M.2., kurse ka pas njohuri se i akuzuari N.M.1. e ka pas dorën e lënduar me sopatë por se çfarë lloji të lëndimeve ka pas për këtë nuk ka njohuri.

Në përgjithësi dëshmitë e këtyre dëshmitarëve u referohen rrethanave pas ndodhjes se rastit kritik – vrasjes së tani të ndjerit B....e që nga Gjykata u vlerësuan si dëshmi të përshkrimeve të veprimeve “ *post festum*” që i referohen çështjeve pas ngjarjes, por që si përshkrime dhe dëshmi u referohen edhe rrethanave të menjëhershme pas ndodhjes së ngjarjes kritike, ku vetura e markës Passat largohet nga vendi i ngjarjes në drejtim të Shtimes e kjo nuk është në kundërshtim edhe me faktin që vetura Passat e familjes M.....pikërisht në atë kohë ka ardh në drejtim të Shtimes dhe ka lakuar në të djathtë për në fshatin Petrovë e që nuk është mohuar as nga i akuzuari N.M.1..

**Dëshmitari R. M,** në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se ditën kritike në orët e pasdites e ka parkuar veturën e tij të markës Wolsfagen në parkingun e pompës së benzinës “ .....” në rrugën Suharekë – Shtime, në fillim aty – parking nuk ka pas veturë tjetër dhe parkingu ka qenë i rrethuar me shirit, e ka shtrirë ulësen e vozitësit dhe ka fjetur në pozitën e shtrirë, në ndërkohë është zgjuar nga zhurma e krismave të armës dhe ka vërejtur se ishte i plagosur në dorën e djathtë në krahun e majtë dhe në pjesën e barkut, ka dal jashtë veturës dhe aty e ka pa një veturë ngjyrë e bardhë parkuar paralel me veturën e tij e që ishte rreth 3 metra larg veturës së tij. Në ulësen e parë të veturës tjetër e ka vërejtur një person të mbështetur në ulëse, ndërkaq në rrugë rreth 10 metra larg ka parë një veturë ngjyrë hiri që lëvizte në drejtim të Shtimes, në këtë veturë ishin dy persona, e njeri që ishte i ulur në ulësen e djathtë e ka pas në dorë një pushkë automatike të kthyer me tytë përpyetë, dera e djathtë e parë e veturës ka qenë pak e hapur dhe kjo veturë është larguar në drejtim të Shtimes.



Dëshmitari ka deklaruar se në momentet kur ka ndodh ngjarja koha ka qenë e vranët me riga shiu por ai ka mundur të vërej dy personat që ishin në veturën me ngjyrë hiri, por që nuk mund t'i identifikoj. Nga lëndimet e marra prej plumbave ka qëndruar në QKUK në Prishtinë 8 ditë dhe deri sa ka qenë i shtrirë në spital ka biseduar me dëshmitarin S.B të cilin më përpara nuk e kishte njohur. Dëmin e shkaktuar në veturën e tij nga plumbat tani të akuzuarit ia kanë kompensuar në tërësi.

**Dëshmitari , Sh.M** përndryshe xhaxha i të akuzuarve N.M.1. e N.M.2. në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se me datë 07.11.2007 kishte shkuar në Banjë të Klllokotit dhe në orët e pasdites kur është kthyer, në fsh. Sojevë, bashkëshortja e tij përmes telefonit e ka njoftuar se ka ndodhur diçka në pompën e benzinës “ .....”, e që dëshmitari pastaj ka shkuar në shtëpinë e tij në fsh. .... Shtime, dhe aty ishte djali i vëllait të tij , N.M.1.u që kishte në dorë pushkën automatike dhe ishte i shqetësuar, i ka treguar dëshmitarit se në fshatin .... në pompën e benzinës “ .....” e kishte vrarë tani të ndjerin B. B, se veturën e kishte lënë në fsh. .... dhe këmbë kishte ardhur në Mollopolc, dëshmitari kur ka kuptuar këtë situatë është interesuar edhe për anëtarët e tjerë të familjes M..... dhe ka kuptuar se N.M.2.u atë ditë kishte shkuar në Ferizaj kurse dëshmitari Sh.... ka porositur edhe persona të tjerë që në rast se e takojnë N.M.2.un ta njoftojnë për rastin me qëllim që të mos i ndodh diçka nga familja B...., por që në ndërkohë në shtëpinë e tij ka shkuar edhe tani i akuzuari N.M.2., e aty kanë ardh edhe familjar të tjerë, kurse dëshmitari përmes telefonit ka ftuar policinë e që patrulla e policisë kanë shkuar në shtëpinë e tij dhe pas kontrollimit të shtëpisë policia e kanë shoqëruar tani të akuzuarin N.M.1.

Dëshmitari, ka deklaruar se në muajin e 11 të vitit 2005, në pompën e benzinës “ .....”, në fsh....., pronë e familjes B....., është vrarë tani i ndjeri F. M – djalë i vëllait dhe vëlla i të akuzuarve N.M.1. e N.M.2. dhe për vrasjen e tij është gjykuar i mituri A.B, përndryshe djalë i vëllait të tani të ndjerit B. B, dhe sipas dëshmitarit në momentin kur ka ndodh kjo vrasje prezent ka qenë edhe tani i ndjeri B..... Ka shtuar se pas ndodhjes së këtij rasti familja B.... sipas traditave rregullisht kanë marr besë nga familja M....., por me kusht që asnjë anëtar i familjes B.....j të mos punojnë dhe të mos shkojnë në pompën e benzinës “

.....” në fshatin ..... Personat e vullnetit të mirë kanë ndërmjetësuar edhe për pajtimin e këtyre dy familjeve por pajtimi nuk është bërë meqë vëllezërit e N.M.2 dhe të N.M.1. në atë kohë ishin jashtë shtetit të Kosovës dhe pritej që në fund të vitit 2007 të ktheheshin për pushime në Kosovë.

**Dëshmitari R.M**, xhaxha i të akuzuarve ka deklaruar se ditën kritike ishte duke shkuar në Ferizaj, kur është njoftuar se ka ndodh një problem në fshatin ....., është kthyer në fshatin ....., ka shkuar në shtëpinë e vëllait Sh..... ku aty ishte N.M.1. por që kanë ardhë edhe familjaret e tjerë, kurse dëshmitari kur ka kuptuar se çka ka ndodh menjëherë ka shkuar në shtëpinë e tij që ishte po ashtu në fshatin .....

**Dëshmitarja Z.M**, bashkëshorte e të akuzuarit N.M.2. dhe kunatë e të akuzuarit N.M.1., ka deklaruar se me datë 07.11.2007, bashkëshorti i saj N.M.2. rreth orës 09:00-10:00 të mëngjesit është nisur për Ferizaj për të rregulluar disa dokumente, edhe pse e kanë pas veturën familjare N.M.2. nuk ka mund me vozit për shkak se dy apo tre muaj më parë kishte operuar këmbën për shkak të një ndërhyrje në vena, ndërkaq dëshmitarja ka shkuar në gjininë e saj për vizitë, kurse në shtëpi ka mbetur kunati i saj N.M.1.u, në bashkësi familjare kanë jetuar me kunetër N.M.1. E e F që kanë punuar në Zvicër dhe fëmijët e kunatit tani të ndjerit F. M.

**Dëshmitarët H.M e I.I** në shqyrtimin gjyqësor, kanë deklaruar se sipas porosisë së familjes B..... – kryefamiljarit F.....i kanë shkuar në familjen M..... në shtëpinë e kryefamiljarit Sh.M dhe sipas traditave kanë kërkuar besë , për faktin se një anëtar i familjes B e kishte privuar nga jeta anëtarin e familjes M..... Besën e kanë marr prej Sh.M dhe familjareve të tij në atë mënyrë që anëtarët e familjes B kanë qenë të lirë të lëvizin jashtë shtëpisë, por kushti ka qenë që asnjë anëtar i familjes B..... të mos punojnë, të mos shkojnë dhe as të mos “ sillen” në dhe rreth pompës së benzinës “ .....” ne ....., pastaj dëshmitaret sipas rregullave kanë shkuar në familjen B..... ua kanë përcjellë “ besën” kryefamiljarit F..... dhe djemve të tij të cilët i kanë falënderuar për këtë veprim duke shtuar se edhe herave

të tjera familja M..... kanë dhënë besë me kushtin e njëjtë, kjo marrje e besës ka ndodh tri – katër ditë para se të ndodh vrasja e tani të ndjerit B.....

**Dëshmitari N.N**, ka deklaruar se në vitin 2007, ka qenë shef i sigurimit në QT ..... në Ferizaj, orari i punës ka qenë prej orës 10:00 – 23:00, në muajin nëntor 2007 (kurse data nuk i kujtohet), ishte në orar të punës rreth orës 13:00 – 14:00, në recepsion është takuar me N.M.2. dhe kanë qëndruar rreth 5 minuta e pastaj dëshmitari është marr me punë në vendin e punës, por që në ndërkohë rreth orës 15:00, në ambientet e restorantit të QT .....e ka parë tani të akuzuarin N.M.2. në shoqëri me një person tjetër, që ishin duke pirë kafe, dhe kanë qëndruar rreth 1 orë, këtë person dëshmitari nuk e ka njohur por që pastaj të njëjtin e ka parë në ndërtesën e PPQ në Prishtinë , kur dëshmitari është ftuar për të dhënë deklaratë.

Ka deklaruar se N.M.2. e njeh përmes vëllait të tij M....., i cili ka qenë shok i ushtrisë me R.M – xhaxha i N.M.2.ut. Ka sqaruar se ne ..... kanë qenë të vendosura kamerat incizuese statike që kanë mbuluar tere hapësirat përfshirë edhe restorantin , por ka pas shpesh ndërprerje të incizimeve për shkak të ndërprerjes të energjisë elektrike por që në përgjithësi kamerat incizuese nuk kanë funksionuar – incizuar siç parashihet për shkak të kushteve dhe teknikes jo adekuate.

**Dëshmitari B.T**, i dëgjuar në cilësi të dëshmitarit në ish PPQ në Prishtinë më 31.01.2008, ka deklaruar se me N.M.2. njihet para 3-4 viteve dhe përmes xhaxhait të N.M.2. H..... kanë caktuar një takim në Qendrën tregtare ..... Ferizaj me datë 07.11.2007, rreth orës 11:00, dëshmitari ka ardhur nga Shkupi i R. Maqedonisë, dhe me N.M.2.un është takuar rreth orës 14:30, janë ulur në restorantin e .....dhe kanë biseduar që dëshmitari N.M.2. të ia rregulloj garancionin për vizë të shtetit të Greqisë dhe pasi që kanë qëndruar deri rreth orës 15:00 janë ndarë dhe dëshmitari ka vazhduar rrugën për në Maqedoni.

Gjykata shtjelloi edhe provat materiale lidhur me këtë çështje penale, të njëjtat i vlerësoi në ndërlidhje edhe me dëshmitë e dëshmitarëve lidhur me gjendjen e ndodhur faktike.

Nga raporti i autopsisë MA07-289 te datës 20.02.2008, është konstatuar se vdekja e tani të ndjerit B. B është shkaktuar nga plagët e shumëfishta nga arma e zjarrit, ndërkaq eksperti mjeko ligjor dr. T.G në ekspertizën e datës 14.07.2009, ka konstatuar se në trupin e tani të ndjerit janë konstatuar 7 plagë në anën e pasme të majtë të trupit, 6 plagë në anën e pasme të djathtë të trupit si dhe dy plagë tej shkuese në anën e përparme të trupit si dhe një plagë tangjenciale.

Nga vërtetimi për sekuestrimin e sendeve te datës 07.11.2007, konstatohet se nga N.M.1. janë marr dy pasaporta, çelësat e veturës Passat , ndërkaq nga procesverbali për kontrollimin e shtëpisë të datës 21.11.2007, nuk është has ndonjë provë që ka të bëjë me veprën penale, ndërkaq me date 07.11.2007 nga i akuzuari N.M.1. është sekuestruar pushka automatike AK-47 me të dhëna si në dispozitiv, nga ekzaminimi i veturës me targa ..... pronë e të akuzuarit N.M.1., në derën e prapme të anës së djathtë janë konstatuar tri vrima hyrëse dhe dy dalje ndërkaq një plumb i armës është gjetur brenda derës së kësaj veture.

Nga raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes i datës 07.11.2007, dhe foto dokumentacioni, është konstatuar se në parkingun e pompës së benzinës ..... është hasur një veturë e markës Peugeot dhe një veturë tjetër e markës Wolsfagen, janë gjetur po ashtu gëzhoja të zbrazura nga pushka automatike, pjesë metalike të predhës, njolla gjaku, pjesë të xhamit të veturës, një vrimë në një shtyllë metali, e të cilat pastaj janë dërguar për ekzaminim të mëtutjeshëm.

Në bazë të raportit të ekzaminimit kriminalistik i armëve të zjarrit i datës 21.04.2008, është konstatuar se dëshmitë e marra në vendin e ngjarjes dhe atë 26 gëzhoja pjesë të fishekëve të kalibrit 7.62 x 39 mm, janë gjuajtur prej të njëjtës armë me të njëjtin kalibër dhe atë nga pushka automatike AK -47 me numër serik 14196528 e cila është sekuestruar nga i akuzuari N.M.1.

Nga raporti mjekësor i datës 20.05.2008 për të dëmtuarin R. M, është konstatuar se ka tri plagë shkuese të shkaktuara nga arma e zjarrit, njëra në shuplakën e dorës së djathtë dhe gishtin e madh të dorës, një plagë shkuese në pjesën anësore të bërrylit të majtë dhe një plagë tjetër në murin e përparmë të barkut – plagë tangjenciale dhe është konstatuar se ka pësuar lëndime të rënda trupore.

Me raportin e përbashkët të ekspertit mjeko ligjor dhe atij të balistikës të datës 14.07.2009, është dhënë mendimi dhe konstatimi se në veturën Passat me targë ..... janë konstatuar 3 vrima dhe atë një në këndin e derës së pasme të djathtë, një vrimë hyrëse – depërtuese me dalje të predhës në metal dhe gomë dhe një vrimë hyrëse depërtuese e predhës në plastik të derës, dhe që është konstatuar rrugëtimi i predhave nga brenda veturës - jashtë deri sa dera e veturës ishte e hapur, se vetura e markës Peugeot e parkuar në parkingun e pompës së benzinës, është goditur në mënyrë automatike e që goditjet janë fokusuar në derën e parë të majtë gati në tërë sipërfaqen e derës dhe janë konstatuar 14 vrima, që njëkohësisht nga këto predha është qëlluar tani i ndjeri B. B, dhe se nga këto predha është goditur në të njëjtën kohë edhe automjeti i markës Wolsfagen që ishte i parkuar vizavi me veturën Peugeot dhe atë 10 projektele kanë depërtuar neper veturën Peugeot duke goditur veturën Wolsfagen, ndërkaq 4 nga predhat nuk kanë depërtuar përtej veturës Peugeot.

Gjykata me 11.10.2011, ka kryer rikonstruksionin në vendin e ngjarjes, me ç ‘rast pjesëtarët e forenzikes ( që kanë bërë shiqimin e vendit të ngjarjes ditën kritike ), kanë vendosur shenjat ashtu siç i kanë hasur, është simuluar vendosja e automjetit të viktimës dhe sipas sqarimeve të të akuzuarit ardhja e tij me veturën Passat, në vendin e ngjarjes, me shpejtësi të ngadalësuar, ndalja në pozicion të volitshëm dhe veprimet e ndërmarra nga i akuzuari, duke kaluar nga ulësja e vozitësit në ulësen e pasme të veturës , hapja e derës të pasme të djathtë dhe shkrepja me pushkë automatike në drejtim të veturës Peugeot.

Gjatë rikonstruksionit në vendin e ngjarjes, është konstatuar se ngjarja ka filluar afër pikës ku është gjetur gëzhoja me nr.17, jashtë rrugës kryesore – trotuar e që eksperti i balistikës ka konstatuar se të shtënat e para kanë filluar kur automjeti i markës Passat ka qenë në rrugë – kjo në bazë të gëzhojës të gjetur ne piken 17 e pastaj janë konstatuar gëzhojat me

nr. 16, 15, 14, 11, 10, 9, 8,7,6,5,3 e 4, gëzhojat janë shpërnda prej numrit 17 deri te numri 4 në distancë prej 11,80 cm, e këto të shtëna janë bërë në vazhdimësi dhe sipas ekspertit këto gëzhoja i takojnë grupit të parë ndërkaq është konstatuar se gëzhojat prej nr. 30 deri te nr.18 e që formojnë grupin e dytë të gëzhojave ( e që i takojnë të njëjtës armë ), janë shpërndarë në një largësi prej 3.53 cm, dhe nga kjo është konstatuar se plumbat nuk janë shkrepur vetëm nga një pozitë, ngase të njëjtat janë të shpërndara dhe me këtë kuptohet se i akuzuari të shtënat në drejtim të veturës së viktimës nuk i ka bërë nga një pozitë e njëjtë, siç ka deklaruar në mbrojtjen e tij tani i akuzuari, N.M.1., dhe ndërkaq eksperti i balistikës ka konstatuar se plumbat janë zbrazur nga pushka automatike kur vetura ishte në lëvizje.

Konstatim i tillë i ekspertit të balistikës, sa i përket të shtënave dhe pozitave të gjuajtjes në veturat, në momentin kritik, është në përputhje të plotë edhe me provat e tjera materiale siç janë shiqimi i vendit të ngjarjes, raporti i autopsisë dhe mendimit të ekspertit mjeko ligjor lidhur me konstatimin e plagëve në trupin e tani të ndjerit B. B, si dhe nga rikonstruksioni në vendin e ngjarjes dhe mendimin e ekspertit të balistikës të dhënë në këtë rast.

#### **5.Vlerësim i provave te paraqitura ne shqyrtimin gjyqësor dhe të gjeturat faktike të gjykatës**

Gjykata, shqyrtoi të gjitha provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor, i vlerësoi një nga një dhe në ndërlidhje kauzale njëra me tjetrën dhe konstatoi se është arritur që plotësisht dhe përtej çdo dyshimi të vërtetohet gjendja faktike e ndodhur me datë 07.11.2007 dhe siç është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit.

Fillimisht, Gjykata konstatoi se janë vërtetuar në mënyrë të pa kontestueshme këto fakte:

-se ditën kritike të datës 07.11.2007 në parkingun e pompës së benzinës “ .....”, që gjendet përkaj rrugës Suharekë – Shtime në fshatin ....., Shtime, në veturën e markës Peugeot, është privuar nga jeta tani i ndjeri B. B,

-se vrasjen e të ndjerit e ka kryer i akuzuari N.M.1, në atë mënyrë që deri në ulësen e vozitësit të veturës Peugeot ishte i ndjeri B....., afër kësaj veture në një distancë të shkurtër rreth 1,5 – 3 metra ndalet vetura e markës Passat me targa të regjistrimit ....., i akuzuar N.M.1. e ka hapur derën e pasme të djathtë të kësaj veture dhe nga pushka automatike AK – 47 ka hapur zjarr, duke e qëlluar derën e vozitësit të veturës Peugeot dhe duke e qëlluar me shumë predha për vdekje tani të ndjerin B. B.

-në të njëjtën kohë, nga plumbat e shkrepur është qëlluar edhe vetura e markës Wolsfagen që ishte e parkuar paralel me veturën Peugeot dhe atë nga 10 plumba që kanë depërtuar neper veturën Peugeot dhe kanë goditur veturën Wolsfagen pronë e R.M i cili në ato momente ishte duke fjetur në ulësen e vozitësit të cilën e kishte shtrirë e që tri nga këto predha e qëllonjë edhe të dëmtuarin R. M dhe atë në njëra në shuplakën e dorës së djathtë dhe gishtin e madh të dorës, një plagë shkuese në pjesën anësore të bërrylit të majtë dhe një plagë tjetër në murin e përparmë të barkut – plagë tangjenciale dhe është konstatuar se ka pësuar lëndime të rënda trupore.

Pasi që Gjykata vërtetoi faktet e cekura, vlerësoi versionet e paraqitura nga palët në procedurë dhe atë versionin e prokurorit se vrasjen e tani të ndjerit Blerim e ka kryer i akuzuari N.M.1. në bashkëkryerje me të akuzuarin N.M.1. dhe njeherit ka shkaktuar rrezik të përgjithshëm në drejtim të të dëmtuarit R. M po ashtu në bashkëkryerje me të akuzuarin N.M.2. dhe versionet e paraqitura nga të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre se i akuzuari N.M.1. ka vepruar i vetëm në kryerjen e veprave penale dhe atë veprën penale të vrasjes e ka kryer në gjendje të tronditjes së fort psikike.

Gjykata vlerësoi këto pretendime, vlerësoi të gjitha provat e çështjes penale duke konstatuar gjendjen faktike që është përshkruar në dispozitiv.

Faktin se i akuzuari N.M.1., ditën kritike e ka privuar nga jeta tani të ndjerin B. B, dhe ka lënduar rëndë nga pakujdesia edhe të dëmtuarin R. M, Gjykata e vërtetoi fillimisht nga mbrojta e të akuzuarit N.M.1. e dhënë në të gjitha fazat e procedurës përfshirë edhe

shqyrtimin gjyqësor dhe në ndërlidhje me të gjitha provat materiale dhe dëshmitë e dëshmitarëve që u paraqiten në shqyrtimin gjyqësor e që do të elaburohen në arsyetimin e këtij aktgjykimi.

U konstatua se me date 07.11.2007 rreth orës 15:30, në parkingun e pompës së benzinës “ ..... ”, ne fshatin .....,Shtime, i akuzuari N.M.1. e privoi nga jeta tani të ndjerin B. B dhe njeherit i shkaktoi lëndime të rënda trupore nga pakujdesia të dëmtuarit R. M, siç u konstatua në pjesën e arsyetuar te faktet e pakontestuar.

Këtë gjendje të fakteve, Gjykata e ka mbështetur edhe nga provat materiale si : shiqimi i vendit të ngjarjes me ç’ rast janë gjetur gëzhojat e pushkës automatike, të ndara në dy pjesë të cilat gëzhoja është konstatuar se janë shkrepur nga arma e njëjtë dhe atë AK – 47 me numër serik ....., e cila armë është sekuestruar nga i akuzuari N.M.1. dhe fakti se të gjitha gëzhojat i takojnë kësaj arme është vërtetuar nga raporti i ekzaminimit kriminalistik <sup>1</sup>, se vetura Peugeot është qëlluar në tërë sipërfaqen e derës se vozitësit duke filluar nga prapa përderisa paralel me t; ka qenë vetura tjetër që është konstatuar se ka qenë e të akuzuarit e që këto vërtetohen nga ekzaminimet e veturave dhe nga ekspertiza e ekspertit të balistikës <sup>2</sup>, nga rikonstrukcioni i vendit të ngjarjes i kryer nga Gjykata me datë 10.11.2011 dhe me mendimin e ekspertit të balistikës të dhënë me rastin e rikonstrukcionit, i cili ka konstatuar se grupi i parë i gëzhojave dhe atë prej gëzhojës në piken nr.17 deri te gëzhoja me nr. 4, janë gjetur skaj rrugës – në trotuar e që tregojnë se janë të zbrazura nga pushka automatike AK -47 përderisa automjeti nga i cili është shtënë ka qenë në lëvizje, kurse grupi tjetër i gëzhojave është shkrepur nga një pozicion tjetër kur i akuzuari pasi ka shkrepur rafalin e parë në veturën Peugeot, ka shkrepur një rafal edhe në ajër.

Gjykata, vlerësoi edhe mbrojtjen e të akuzuarit N.M.1. dhe të mbrojtësit të tij se i akuzuari e ka privuar nga jeta të ndjerin B....., duke qenë në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore, se aftësia e të akuzuarit për ti kontrolluar veprimet e veta ishte dukshëm e zvogëluar, dhe atë për faktin se në të njëjtin vend, dy vite më parë ishte vrarë vëllai i tani të

---

<sup>1</sup> Raporti I shiqimit të vendit të ngjarjes I dates 07.11.2007, dhe raporti I ekzaminimit kriminalistik të armeve të zjarrit I dates 21.04.2008,

<sup>2</sup> Shiqo ekspertizen e ekspertit të balistikës te dates 14.07.2009



akuzuarit N.M.1., F. M, nga një anëtar i familjes B....., e që si version të tillë Gjykata nuk e pranoi për këto arsye:

-I akuzuari N.M.1., ditën kritike në veturën e tij e kishte vendosur pushkën automatike AK- 47 “ armën në veturë e kam mbajtur nga frika se anëtarët e familjes B....., mund të me vrasin, nga frika se unë mund ti vrisja ata” <sup>3</sup>, për të vazhduar më tutje “ kur jam kthyer nga Suhareka në Qafen e Duhlës, pushkën e kam nxjerr prej kipekut dhe e kam vendos në ulësen e pasme të veturës”, për të shtuar më tutje “ pasi kam gjuajt në drejtim të veturës Peugeot, para se me hy në veturën time disa predha të automatit i kam shkrepur në ajër, pa ndonjë qëllim të caktuar “<sup>4</sup>.

Lidhur me këtë, i akuzuari N.M.1. në procedurë paraprake në ish PPQ në Prishtinë në prani të avokatit mbrojtës me datë 11.12.2007, në mbrojtjen e tij ka deklaruar : “ kur kam kaluar nga pompa e benzinës ....., më ka vluar gjaku pasi që në atë pompë të benzinës para dy viteve vëllai im F..... është vrarë, në atë vend” <sup>5</sup>, i akuzuari N.M.1. me datë 07.11.2007 në deklaratën e dhenë në Njesinë e Hetimeve Rajonale në Ferizaj, në praninë e avokatit mbrojtës, rreth motivit të kryerjes së veprës penale të vrasjes ka deklaruar “ unë B. B e kam vrarë për shkak të hakmarrjes, për shkak se para dy viteve vëllai im F..... te i njëjti vend është vrarë nga familja B.....” <sup>6</sup>

Ngjarja kritike është zhvilluar në praninë e një dëshmitari të vetëm dhe atë R. M, dëshminë e të cilit Gjykata e vlerësoi në kontekst të ngjarjes por në suaza të deklarimeve të këtij dëshmitari se në vend ngjarje e ka vërejt tani të ndjerin Blerim të mbështetur në ulësen e vozitësit të veturës me ngjyrë të bardhë dhe dy persona të tjerë në një veturë tjetër e që njeri prej tyre në dore e mbante armën me tytën përpjetë. Gjykata vlerësoi edhe dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë jo okular të rastit për të konstatuar dhe gjetur motivin e të akuzuarit N.M.1. për ta privuar nga jeta tani të ndjerin B..... dhe pas vlerësimit të gjithanshëm të të gjitha provave dhe vlerësimit logjik të ngjarjes pa dyshim konstatoi se i akuzuari N.M.1. veprën penale të vrasjes e ka kryer nga motivet e hakmarrjes.

---

<sup>3</sup> Pjesë e mbrojtjes së të akuzuarit N.M.1. në shqyrtimin gjyqësor të dates 20.04.2015,

<sup>4</sup> Po aty si në fusnoten numer 3

<sup>5</sup> Pjesë e mbrojtjes së të akuzuarit N.M.1. azmi në ish PPQ në Prishtinë me date 11.12.2007

<sup>6</sup> Pjesë e deklaramit të të akuzuarit N.M.1 ne NJHR me 07.11.2007,

Është vërtetuar se dy vite para ndodhjes së kësaj ngjarje, në muajin nëntor të vitit 2005, pikërisht në të njëjtin vend, pra, në pompën e benzinës, ishte privuar nga jeta tani i ndjeri F. M – vëlla i të akuzuarit N.M.1., që vrasjen e ka pranuar dhe për këtë veprë është gjykuar A.B, djalë vëllai i tani të ndjerit B. B, e që motivi i hakmarrjes përpos këtyre fakteve u vërtetua edhe nga vet mbrojtja e të akuzuarit N.M.1. dhe Gjykata në këtë mënyrë vërtetoi edhe qëllimin mendor kriminal “ *mens rea*” të të akuzuarit N.M.1. për të kryer vrasjen siç u përshkrua më lartë.

Mbajtja e pushkës automatike në veturë, shkuarja e të akuzuarit në pompën e benzinës në parkingun e të cilës po qëndronte vetura e tani të ndjerit, kuptohet se i akuzuari ka pas për qëllim kështu që të realizoj dhe ka realizuar elementin “ *actus reus*”, pra, shkuarja në vend të ngjarjes duke shkrepur nga pushka automatike në veturën e të ndjerit, e që të gjitha këto veprime zbardhin qëllimin e hakmarrjes nga i akuzuari N.M.1..

Dhe me këto fakte të vërtetuara, teza e mbrojtësit dhe e të akuzuarit se ka vepruar në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore në momentin kritik nga Gjykata u vlerësua si “ supozim” dhe tentativë për të ikur nga kualifikimi i drejtë, real dhe ligjor i veprimeve të të akuzuarit në rastin konkret, po i referohemi vetëm një fakti të cilin edhe vet i akuzuari N.M.1. e ka pohuar se e ka pa veturën Peugeot të parkuar në parkingun e pompës së benzinës, e ka ditur se është e familjes B....., në ulësen e vozitësit e ka parë një djalë të F.B dhe me pushkë automatike ka shkrepur rafalë në drejtim të kësaj veture dhe të personit që ishte në veturë.

Për tu realizuar figura e veprës penale vrasja në gjendje të afektit mendor që ndryshe në praktiken gjyqësore njihet si vrasje e provokuar duhet të përmbushen disa elemente e një nder to duhet të ekzistoj sulmi, keqtrajtimi, fyerja e rëndë dhe tronditja e fortë e kryesit e shkaktuar me sjelljet e viktimës e që në rastin konkret siç është vërtetuar asnjë element i tillë nuk është përmbushur dhe as që është reflektuar nga tani i ndjeri B. B në drejtim të të akuzuarit siç është elaboruar në pjesën dënuese të aktgjykimit.

## II

**Sa i përket pjesës liruese të këtij aktgjykimi**, kontestuese ishte fakti se i akuzuari N.M.2. a ka qenë pjesëmarrës në ngjarjen kritike bashkë me të akuzuarin N.M.1. dhe veprat penale a i kanë kryer në bashkëkryerje.

Përgjigjja në pyetjet e parashtruara e zgjidh edhe dilemën dhe aspektin subjektiv të çështjes, meqë në pjesën gjyquese të aktgjykimit u shtjellua dhe u vërtetua komponenta objektive dhe ajo subjektive në drejtim të të akuzuarit N.M.1., ndërkaq Gjykata në shqyrtimin gjyqësor është përqendruar në gjetjen dhe vërtetimin e elementit subjektiv të veprës penale në tërësi, ngase kjo komponentë ka qenë enigmatike dhe e pa qartësuar po ashtu e pa ndriçuar, e që në këtë drejtim edhe Gjykata e Apelit e Kosovës në instruksionet e dhëna në vendimin e saj, ka potencuar se nuk është ndriçuar fakti se në ngjarjen kritike a kanë marr pjesë të dy të akuzuarit – pra N.M.1. e N.M.2. dhe në kryerjen e veprës penale. Prandaj Gjykata në përpjekje që ta gjej të vërtetën materiale, vlerësoi dhe analizoi të gjitha provat dhe dëshmitë, e që kjo pjesë e aktgjykimit do të përqendrohet pikërisht në trajtimin dhe gjetjen e faktit të pjesëmarrjes apo jo të të akuzuarit N.M.2. në ngjarjen kritike.

Fillimisht do të trajtohen dëshmitë e dëshmitarëve në drejtim të këtij fakti, mbrojtjet e të akuzuarve dhe ndërlidhjet me provat materiale.

I akuzuari N.M.2., ka mohuar pjesëmarrjen e tij në ngjarjen e ditës kritike, duke deklaruar se atë ditë ishte në Ferizaj, në QT ....., është takuar me N.N, është ulur në restorantin e kësaj qendre tregtare me personin B.T ku ka qëndruar prej orës 14:00-15:00<sup>7</sup>, e që në mënyrë identike ka deklaruar edhe në procedurë paraprake si dhe në shqyrtimin në ish Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.

---

<sup>7</sup> Mbrojtja e të akuzuarit N.M.2., e dhënë në shqyrtimin gjyqësor me 20.04.2015,

I akuzuari N.M.1, në të gjitha fazat e procedurës ka deklaruar se ditën kritike me veturën Passat, ka qenë i vetëm, po ashtu edhe në vendin e ngjarjes kur ka kryer veprat penale, vëllai i tij N.M.2.u në mëngjes të asaj dite është nisur prej shtëpisë Shtime për në Ferizaj ku atje ka pas për tu takuar me një person për rregullimin e disa dokumenteve<sup>8</sup>.

Dëshmitarja Z.M, ka deklaruar se i akuzuari N.M.2. me datë 07.11.2007 rreth orës 09:00 - 10:00, ka dal nga shtëpia për të shkuar në qytetin e Ferizajt ku ka pas për ti rregulluar disa dokumente.

Dëshmitari Sh.M, ka deklaruar se, ditën kritike kur është kthyer në shtëpinë e tij nga Kllokoti, aty ishte djali i vëllait N.M.1.u dhe pasi i tregoi për rastin e ndodhur në pompën e benzinës, dëshmitari është interesuar për anëtarët tjerë të familjes M....., dhe kur kuptoi se djali i vëllait N.M.2.u kishte shkuar në Ferizaj, ka porositur personat e tjerë që ta njoftojnë N.M.2.un për rastin e ndodhur në rast se e takojnë, kjo me qëllim që të shmang ndonjë problem tjetër.

Dëshmitari ka deklaruar se në ndërkohë në orët e mbrëmjes në shtëpinë e tij në fsh. Mollopolc, ka ardh edhe N.M.2., dëshmitari ka njoftuar policinë për rastin e ndodhur e që në shtëpinë e tij kanë ardh policia dhe pas procedurave të kontrollit e kanë arrestuar N.M.1., nuk kanë kërkuar person tjetër, ndërkaq N.M.2. e kanë arrestuar 2 javë më pas.

Nuk ka dyshim se të gjitha këta dëshmitar, përfshirë edhe të akuzuarin N.M.1., përpiqen që të vërtetojnë të njëjtën gjë, se N.M.2. ditën dhe në momentin kritik nuk ishte në vendin e ngjarjes, kjo nga Gjykata është edhe e kuptueshme, duke pas parasysh afërsinë familjare në mes të dëshmitarëve dhe të akuzuarit N.M.2. por në anën tjetër dëshmitarët N.N dhe B.T. që konsiderohen si dëshmitar neutral – të pa anshëm të ngjarjes pohojnë faktin se ditën kritike rreth orës 13:00 deri rreth orës 15:00 N.M.2. e kanë takuar në ..... në Ferizaj, e që dëshmitari B.T ka qëndruar në restorantin e .....me N.M.2.un deri rreth orës 15:00 “ *me N.M.2. jemi*

---

<sup>8</sup> Mbrojtja e të akuzuarit N.M.1. e dhënë në procedure paraprake me date 07.11.2007, 11.12.2007 dhe në shqyrtimin gjyqësor me date 20.04.2015,

*takuar rreth orës 14:30 dhe kemi biseduar dhe kemi ndejtur deri në ora 15:00.... dhe kemi biseduar lidhur me rregullimin e vizës për Greqi”<sup>9</sup>.*

Dëshmitari N.N ka deklaruar se në QT .....hapësirat kanë qenë të mbuluara me incizim prej kamerave e që nganjëherë edhe nuk kanë funksionuar për shkak të kushteve dhe teknikes jo adekuate.

Lidhur me incizimet në QT .....për datën 07.11.2007, Gjykata ka angazhuar ekspertin nga lemia e kamerave e po ashtu në shqyrtimin gjyqësor publikisht ka shiquar CD-në e siguruar për këtë datë me incizimet në pjesët e restorantit dhe të hapësirave të tjera por që në asnjë pjesë të incizimeve të CD-së nuk është identifikuar i akuzuari N.M.2., në anën tjetër eksperti nga lemia e kamerave F.H pas shiqimit të CD-së, në shqyrtimin gjyqësor të datës 02.04.2015, ka deklaruar se incizimet në këtë CD janë bërë prej një kamere amatore, në një plan total, nga kamera statike dhe incizimi është bërë prej një pjese më të lartë dhe xhirimi është bërë vetëm në një plan, kualiteti i kamerës ka qenë i dobët meqë objektivat e kapura me kamerë nuk kanë pastërti të fotografisë dhe hapësira që është incizuar ka mundur të kap një gjerësi 2-3 metra dhe sipas identifikimeve fokusi i kamerës ka qenë në drejtim të shankut të restorantit dhe atë në anën e majtë në një gjerësi prej 2 metra, edhe përkundër faktit se incizimet janë bërë nga 3 kamera nga 3 kënde të ndryshme me një kualitet të njëjtë – të dobët të incizimit, pra nuk është incizuar në tërësi objekti në pjesën e brendshme.

Dëshmitari R. M, në të gjitha fazat e procedurës penale ka deklaruar se në vendin e ngjarjes në momentin kritik në veturën ngjyrë hiri i ka pa dy persona, njeri në dorë kishte armë por që dëshmitari ka deklaruar se nuk mund t’i identifikoj, në këtë kontest edhe pse dëshmitari R. M është dëshmitar okular i ngjarjes kritike, dëshmia e tillë nuk ka mundur nga Gjykata që të trajtohet me tepër në zbardhjen e faktit të pjesëmarrjes apo jo të të akzuarit N.M.2. në ngjarjen kritike, sepse dëshmitari përpos që ka pohuar se i ka parë dy persona në

---

<sup>9</sup> Pjesë e deklarimit të dëshmitarit në Ish PPQ në Prishtinë me 31.01.2008

veturën ngjyrë hiri nuk ka mund t'i identifikoj, apo përshkruaj se paku pamjen apo ndonjë tipar të tyre për arsytet që i ka cekur se ka qenë duke fjetur në momentin kritik <sup>10</sup>.

Dëshmitari S.B, në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se me datë 07.11.2007, rreth orës 15:00, deri sa ishte i ndalur me veturën dhe me vëllain e tij në udhëkryqin për në fshatin Godanc, e ka vërejtur veturën e familjes M..... duke ardhur prej drejtimit Suharekë Shtime me një shpejtësi mjaft të madhe dhe para se të arrij tek vendi ku ishte dëshmitari, në një distancë rreth 30 metra kjo veturë ka dredhuar në anën e djathtë për në fshatin Petrovë, dëshmitari ka vërejtur se i akuzuari N.M.2. e ka vozitur këtë veturë kurse i akuzuari N.M.1. ishte i ulur në ulësen e parë të cilin nuk ka mundur ta vërej mirë.

Në procedurë paraprake dëshmitari ka deklaruar se “ *ata kanë qenë në veturën Passat ngjyrë hiri që vinte nga drejtimi i Prizrenit, kjo veturë ka ardh në drejtim tonin, pasi kanë vërejtur veturën tonë kanë bërë lëvizje të pakontrolluara dhe kanë hyrë në rrugën për Petrovë, veturën Passat e ka vozit N.M.2., ndërsa në anën e djathtë të pasagjerit ka qenë vëllai i tij N.M.1.* ” për të vazhduar më tutje “ *N.M.2. e ka drejtuar veturën ndërsa N.M.1. ka qenë në anën e djathtë dhe atë prej një distance të cilën nuk më kujtohet, por i kam parë pasi i kam njohur, por jam i sigurt se vëllain tim e ka vra N.M.2. por ka mund me qenë edhe N.M.1. por ka pas edhe persona të tjerë*” <sup>11</sup>

Rreth këtij fakti dëshmitari S..... në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me 18.02.2009 në Ish Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, ka deklaruar “ *në veturë i kam parë vetëm dy të akuzuarit N.M.1. e N.M.2.* ”.

Në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur në këtë Gjykatë me 17.10.2014 dëshmitari lidhur me këtë deklaron “*Q..... më tha qe M....., unë i thash po i shoh, në veturë kanë qenë dy persona*”, këtu dëshmitari ndalet nga dhënia e dëshmisë dhe në pyetjen e prokurorit se : kush kanë qenë këta persona në veturën Passat? Dëshmitari pastaj shprehet “ *aman prokuror mos më pyet më tutje se nuk jam në gjendje të mirë shëndetësore sepse të gjitha i kam thënë në*

---

<sup>10</sup> Dëshmia e R.M në Ish PPQ në Prishtinë me 03.12.2007, në shqyrtimet gjyqësore me 18.02.2009 e 18.02.2015

<sup>11</sup> Pjesë e deklarates së dëshmitarit S.....e dhënë në Ish PPQ në Prishtinë me 14.01.2008,

*prokurori dhe në Gjykatën e Prishtinës”, për të vazhduar pastaj në shqyrtimin gjyqësor të datës 25.11.2014 “në veturën Passat i kam vërejt dy persona , në veturën e familjes M..... mua mu ka fiksuar në kokë se në këtë veturë ka qenë N.M.2., këtë e them nga fakti se jemi njohur edhe para kësaj ngjarje dhe se një ditë përpara se të ndodh ngjarja e kam parë N.M.2. te shkolla E.D” pastaj dëshmitari ka vazhduar “ në këtë veturë e kam vërejt që N.M.2. e ka vozit, kurse ka qenë edhe personi i tjetër në veturë që nuk ka mund me pa mirë por ka qenë N.M.1., të cilin nuk e kam pa kuart , ka qenë i ulur në ulësen e parë të pasagjerit, kjo ka ndodh rreth orës 15:00, koha ka qenë e vranët me shi që herë ka ra e herë është ndalur”.*

Dëshmitari Q.B , në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se me datë 07.11.2007 deri sa ishte me vëllain e tij S..... i ndalur në rrugë meqë vetura e tyre ishte defekt nga drejtimi Prizren – Shtime ka vërejt veturën Passat të familjes M..... duke lëvizur me një shpejtësi të madhe dhe është kthyer për në fshatin Petrovë, koha ka qenë e vranët dhe herë herë ka ra shi e që dëshmitari ka deklaruar se këtë veturë e ka vozitur N.M.1. kurse në ulësen e pasme ka qenë dhe një person tjetër të cilin nuk e ka njohur, dëshmitari ka sqaruar se N.M.2. e ka njohur edhe përpara këtij rasti kurse të akuzuarin N.M.1. nuk e ka njohur, por e din që ka ardh prej Zvicre dhe ka degjuar se e ka pas dorën e lënduar.

Në procedurë paraprake dëshmitari ka deklaruar identik si në shqyrtimin gjyqësor kurse veturën e markës Passat që ka shkuar në drejtim të fshatit Petrovë e kanë vërejt nga një distancë 20-30 metra dhe se “ vëllain tim Blerimin e ka vranë N.M.2., me N.M.2.un kemi qenë në luftë, ka qenë i aftë për luftë , ndërsa N.M.1. ka ardh nga Zvicra dhe nuk është në gjendje me shti me armë pasi që me një dorë nuk ishte në gjendje të shtinë me armë”<sup>12</sup>

Duke analizuar dëshmitë e këtyre dëshmitarëve të dhëna në fazat e procedurës penale, Gjykata konstatoi se të njëjtat janë dubioze, sidomos dëshmitë e dëshmitarit S....., rreth faktit se cilët persona i ka parë në veturën e familjes M..... te rruga për në fshatin Petrovë, përderisa në procedurë paraprake dhe në ish Gjykatën e Qarkut në Prishtinë ka deklaruar se në veturë i ka parë N.M.2. dhe N.M.1., në shqyrtimin gjyqësor me 25.11.2014 ka deklaruar se N.M.1. nuk e ka vërejt kuart dhe për këtë devijim të dëshmimeve arsyetohet se nuk ka dashur që

---

<sup>12</sup> Pjesë e deklaratës së dëshmitarit Q..... në ish PPQ në Prishtinë me 04.01.2008,

në shqyrtimin gjyqësor të hyj në detaje të ngjarjes, por se ngjarjen “ e kam të incizuar në trurin tim” dhe më tutje ka deklaruar “mua mu ka fiksuar në kokë se në këtë veturë ka qenë N.M.2.u”.

Gjykata, në mënyrë profesionale të gjitha dëshmitë e dëshmitarëve, në veçanti në kontekstin e pjesëmarrjes apo jo në ngjarjen kritike të të akuzuarit N.M.2., i cili implikohet në ngjarjen e ditës kritike nga dëshmitë e dëshmitarëve S e Q.B, që dëshmitë e tilla të këtyre dy dëshmitarëve i trajtoi në kompleksitetin e çështjes dhe vlerësimit të të gjitha provave dhe erdhi në përfundim se dëshmitë e këtyre dy dëshmitarëve kanë dallime sa i përket faktit se cilët persona i kanë parë në veturën Passat në momentin kur kjo veturë është kthyer për në fshatin Petrovë, përderisa dëshmitari S..... në procedurë paraprake se veturën e ka vozitur N.M.2.u dhe në anën e djathtë ka qenë i ulur N.M.1., ndërkaq në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur në këtë Gjykatë deklaroi se mu ka fiksuar në kokë se këtë veturë e ka vozit N.M.2., e këtë nga fakti se N.M.2. e ka njoft edhe përpara këtij rasti dhe se N.M.1. nuk e ka pa qartë, në anën tjetër ka deklaruar se anëtarët e familjes M..... i ka njohur dhe atë N.M.2.un e N.M.1. si dhe vëllezërit e tyre F..... dhe E..... që kanë qenë në atë kohë në Zvicër dhe se N.M.1, e ka pas dorën e lënduar.

Përndryshe dëshmitari Q..... ka deklaruar se në veturë e ka njoft N.M.2. kurse personin tjetër nuk e ka njohur, ndërkaq ka pas njohuri se N.M.1. në atë kohë e ka pas dorën e lënduar, përndryshe bindja e të dy dëshmitarëve është se aktin e vrasjes e ka kryer N.M.2. jo N.M.1. për arsye që u cekën nga dëshmitarët.

Nga provat materiale të çështjes penale që ndërlidhen me konstatimin e gjendjes faktike të ndodhur në rastin kritik në vendin e ngjarjes dhe atë nga mendimet e ekspertit të balistikes me rastin e rikonstruksionit në vendin e ngjarjes është konstatuar se plumbat e shkrepur nga pushka automatike nuk janë bërë vetëm nga një pozitë por janë zbratur deri sa automjeti nga i cili është shtënë ka qenë në lëvizje, Gjykata këtë rrethanë e vlerësoi në veçanti duke e ndërlidhur edhe me të gjitha provat e tjera dhe konstatoi se edhe përkundër faktit që kjo ekspertizë është e bazuar në faktet dhe çështjet e konstatuara në vendin e ngjarjes por, në anën



tjetër ekspertiza e tillë nuk vërteton faktin apo anën subjektive të pjesëmarrjes të të akuzuarit N.M.2. në ngjarjen kritike.

Gjykata, në përgjithësi në vlerësimin e çështjes penale konkrete siç ka konstatuar më lartë ka gjetur dhe ka vërtetuar komponentin objektiv dhe atë subjektiv në drejtim të të akuzuarit N.M.1., por çështja e pjesëmarrjes së të akuzuarit N.M.2. në ngjarjen kritike ishte një sfidë për Gjykatën por që gjatë analizimit dhe vlerësimit në përgjithësi të të gjitha provave dhe dëshmimeve të dëshmitarëve konstatoi përfundimisht se deklaratat e dëshmitarëve S e Q.B se në rastin tragjik a kanë qenë apo jo të dy të akuzuarit, u vlerësua si dëshmi në drejtim të involvimit të të akuzuarit N.M.2. e N.M.1. në ngjarjen kritike që në një mënyrë edhe u kuptua nga Gjykata kur fillimisht mirret parasysh frustrimi i këtyre dy dëshmitarëve nga ngjarja kritike – të ndjerin B..... e kanë pas vëlla, që në një mënyrë dëshmitarëve u ka dhënë emocione me motive akuzuese për të dy të akuzuarit ( edhe përkundër faktit se dëshmitarët janë njoftuar që të dëshmojnë të vërtetën dhe për pasojat e dëshmisë jo të vërtetë), ndryshe nuk mund të kuptohen dëshmitë e tilla kontradiktore e kontraverse të këtyre dy dëshmitarëve, pastaj deklarimi i dëshmitarit S.....për pjesëmarrjen e të akuzuarit N.M.2. në ngjarjen kritike “ *kjo mu ka fiksuar në kokë*” bindjen e dëshmitarëve se aktin e vrasjes e ka kryer i akuzuari N.M.2. – bindje kjo e pa provuar, dhe se N.M.1. e ka pas dorën e lënduar, por që nga eksperti mjeko ligjor dr. T.G dhe mendimi i tij i dhënë në shqyrtimin gjyqësor me datë 02.02.2011 është konstatuar se N.M.1. ka pas lëndim në gishtin e katërt dhe se ky lëndim nuk ndikon absolutisht në procesin e gishtave të tjerë, dhe se i akuzuari ka qenë në gjendje të gjuaj me armë me të dyja duart.

Çështje tjetër që u vlerësua nga Gjykata ishte edhe mundësia reale që dëshmitarët S..... e Q..... a kanë mundur që në veturën Passat t’i vërejnë dhe t’i njohin personat apo personin brenda në veturë, në kushtet e tilla atmosferike – kohë e vranët me riga shiu, në rrethanën kur vetura e markës Passat ka lëvizur me një shpejtësi mjaft të madhe – që është pohuar edhe nga dëshmitarët dhe së fundi edhe distanca prej vendit ku dëshmitarët kanë qenë duke qëndruar (sipas tyre e ky vend nuk ka mund të konstatohet zyrtarisht ), dhe prej atij vendi e kanë vërejt veturën Passat kur ka dredhuar për në fshatin Petrovë e që me rastin e rikonstruksionit të vendit të ngjarjes është konstatuar se kjo distancë 78 metra , që Gjykata me një vlerësim

logjik por gjithnjë të ndërlidhur me të gjitha provat konkrete konstatoi se në ato kushte dhe në atë distancë identifikimi apo njohja e personave brenda në veturë është thujse i pamundur, por edhe për faktin se dëshmitari S....., N.M.2. e ka njohur mirë kurse personin tjetër nuk ka mund me pa kjar – siç është deklaruar vet dëshmitari.

Gjykata vlerësoi dëshmitë e këtyre dëshmitarëve edhe në aspektin tjetër dhe atë njohjen e mëparshme të dëshmitarëve me të akuzuarit dhe vëllezërit e tyre, duke e ditur se F..... dhe E. M – vëllezër të N.M.1. dhe N.M.2. gjenden në Zvicër, kurse N.M.1. e N.M.2. në atë kohë ishin në Kosovë, se N.M.1. në kohën e ngjarjes e ka pas dorën e lënduar dhe nuk ka pas mundësi me shkrep nga arma, për të konstatuar se dëshmitë e tilla janë të orientuara në drejtim të bartjes së veprimeve inkriminuese të ngjarjes të akuzuarit N.M.2. , si të vlerësohen dhe të kuptohen ndryshe dëshmitë e tilla të këtyre dëshmitarëve të dhëna neper të gjitha fazat e procedurës penale, e kur provave u shtohen edhe dëshmitë e dëshmitarëve N.N dhe B.T të cilët vërtetojnë takimin e tyre me N.M.2. ditën kritike siç është sqaruar më lartë atëherë përfundimisht Gjykata konstatoi se i akuzuari N.M.2. nuk ishte pjesëmarrës në ngjarjen kritike dhe me këtë edhe bashkë kryes i veprave penale për të cilat është akuzuar me aktakuzën e prokurorit të shtetit.

Duke pas parasysh faktin se Gjykata me rastin e vendosjes në një çështje penale e ka për obligim ligjor që të provoj gjithanshëm dhe në mënyrë të pa kontestuar të gjitha faktet të cilat janë në favor dhe në disfavor të të akuzuarit e duke u ndërlidhur me prezumimin e pafajësisë dhe parimin in “*dubio pro reo*”, se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen t; interpretohen në favor të të akuzuarit dhe të të drejtave të tij, Gjykata siç u theksua më lartë nuk gjeti fakte të pakontestueshme për pjesëmarrjen e të akuzuarit N.M.2. në ngjarjen kritike.

Gjykata, po ashtu, pati parasysh edhe faktin se të gjitha argumentet që janë “*in peius*” në drejtim të të akuzuarit N.M.2., nuk janë argumentuar me siguri të plotë dhe plotësisht, përtej dyshimit të bazuar “*beyond reas on able doubt*” dhe pasi që nuk u arrit diçka e tillë dhe u

konsiderua se nuk ekzistojnë, kurse faktet e argumentuara që janë “ *in favoren*” në favor të të akuzuarit u konstatua se të tillat ekzistojnë.

Barra e të provuarit i takon organit të akuzës, ndërkaq çdo dyshim duhet të shkoj në favor të të akuzuarit, kurse prezumimi i pafajësisë, nënkupton Gjykata nuk duhet që çështjes konkret ti qaset me iden e preudikimit se i akuzuarit ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, parime këto fundamentale të procedurës penale të parapara në dispozitën e nenit 7 të KPPK-së, e të cilat garantohen edhe Konventa Evropiane për Te Drejtat dhe Liritë e Njeriut.

#### **6.Vleresimi juridik çështjes për të akuzuarin N.M.1.**

Si rezultat i administrimit të të gjitha provave, në mënyrë të sigurve është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit N.M.1. , qëndrojnë të gjitha elementet subjektive dhe objektive që ndërtojnë figurën e veprës penale vrasja e rëndë nga neni 147 par. 1 nen par. 9 të KPK-së, dashjen për ta kryer këtë vepër penale i akuzuari e manifestoi duke shtënë me pushkë automatike në veturën dhe në vet të ndjerin nga një distancë e afërt e që dashja e tij ishte e orientuar në privimin nga jeta të të ndjerit B. B, e që njëkohësisht me këto veprime nga pakujdesia duke mos e ditur se paralel me veturën e të ndjerit B..... ishte edhe vetura e të dëmtuarit R. M në të cilin ishte duke fjetur i dëmtuari, kur ka shkrepur në drejtim të veturës Peugeot predhat kanë kaluar neper këtë veturë dhe kanë qëlluar veturën e të dëmtuarit R. M dhe vet të dëmtuarin, e që në këto veprime të të akuzuarit, Gjykata konstatoi se ekzistojnë të gjitha elementet dhe tiparet subjektive dhe objektive që përbëjnë figurën e veprës penale shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291 par. 6 lidhur me par. 1 te KPK-së, siç ekzistojnë edhe elementet e veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 2 të KPK-së, për të cilat vepra penale i akuzuari është penalisht përgjegjës dhe është shpallur fajtor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### **8.Përcaktimi i dënimit**

Gjykata me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin N.M.1. pati parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit të parapara në nenin 64 të KPK-së.

Si rrethana lehtësuese për të akuzuarin gjeti se me parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë veprë penale, rrethanat sociale dhe familjare, prind i 4 fëmijëve. Si rrethana renduese, Gjykata ka gjetur se në veprimet e të akuzuarit është manifestuar vullneti për të kryer veprën penale të vrasjes që paraqet shkallë të lartë të rrezikshmërisë shoqërore dhe intensitet i lartë i rrezikimit dhe dëmtimit të vlerës së mbrojtur – jeta e njeriut, rrethanat e kryerjes së veprës penale të vrasjes së rëndë, mënyra e kryerjes së veprës, duke shtënë rafal me pushkë automatike në të ndjerin, papritmas dhe në mënyrë të befasishme përderisa i ndjeri ishte i ulur në ulësen e veturës e pastaj edhe zbrazja e disa predhave në ajër që nënkupton një shfaqje e manifestimit të vullnetit dhe qëllimit për të kryer veprën penale.

Mbi bazën e këtyre rrethanave Gjykata të akuzuarit i shqiptoi dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 18 (tetëmbëdhjetë) vite, me bindje se dënimi i shqiptuar është në harmoni me peshën e veprës penale, përgjegjësinë penale të të akuzuarit, dhe se dënimi i shqiptuar do ti shërbej preventives speciale duke ndikuar në të akuzuarin dhe në risocializimin e tij dhe njeherit do ti shërbej edhe preventives gjenerale duke ndikuar te personat e tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale.

### **9.Llogaritja e paraburgimit, konfiskimi , shpenzimet e procedurës penale**

Në dënimin e shqiptuar të akuzuarit, i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim siç parashihet në nenin 73 par. 1 të KPK-së, ndërkaq me aktvendim të veçantë i është vazhduar paraburgimi deri sa aktgjykimin të marrë formën e prerë por jo më gjatë se koha e dënimit e caktuar me aktgjykim.

Në bazë të nenit 328 par. 3 të KPK-së, konfiskohet në mënyrë të përhershme arma që është përdorur për kryerjen e veprës penale dhe atë pushka automatike AK -47 me numër serik .....

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 99 e 102 e 103 të KPPK-së, duke pas parasysh lartësinë e shpenzimeve për ekspertët dhe paushalli gjyqësor duke pas parasysh komplikueshmerinë e procedurës penale dhe njeherit edhe gjendjen ekonomike të të akuzuarit.

Nga arsyet e cekura më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIAJ**  
**DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**  
**PKR- 234/2013**  
**Më, 8 qershor 2015**

Sekretare juridike,  
Qëndresa Bobi

Kryetari i trupit gjykues- gjyqtari,  
**I b r a h i m I d r i z i**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të kopjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

